



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:005346

Datë: 04.12.2018

Numri i dokumentit: 00182076

**P. nr.119/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndim i lehte trupor nga neni 188/3-1-1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore—DP në Gjakovë, PP.nr.1016/17 të datës 09.02.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **16.11.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të dëmtuarës E. K. si dhe të akuzuarit R. K., te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **R. K.**, i biri Sh. dhe i nezes E. e gjinisë H., data e lindjes..., në fsh. R. K Gjakovë, tani me banim ne Gjakovë, Rr..., ka te kryer shkollën e mesme, kuzhinier, e gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 3 fëmijëve, ID ....

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:**

**-Me dt. 06.07.2017, rreth orës 20:00**, në shtëpinë tyre të përbashkët në Gjakovë, rr..., i pandehuri, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarës E. K. në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike ka konsumuar alkool dhe pasi është kthyer në shtëpi nga puna ka filluar ta fyej të dëmtuarën, të i demolojë dhe ti thyej gjësendet e shtëpisë, e pasi e dëmtuara i thotë që të ndalet, në shenjë revolte të njëjtën e godet me grushte në pjesë të ndryshme të trupit me ç’ rast të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore.

**-me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehte trupor nga neni 188/3-1-1.4 te KPRK-së**

Andaj gjykata në bazë te nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës, dhe nenit 188/3-1-1.4 te KPRK-ës dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarit i shqipton:

**DENIM ME KUSHT**

Dënim me burgim me kohëzgjatje prej **6(gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohet i akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguajë shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, në emër të shpenzimeve procedurale shumë prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të marr formë të prerë, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

**Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese të dënimit me kusht do ta bene Shërbimi Sprovues i Kosovës Dega në Gjakovë .**

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.1016/17 të datës 09.02.2018, ndaj të akuzuarit R. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3-1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar me datë 16.11.2018, Prokurori shtetit Bajram Kryeziu lexon aktakuzën PP.nr.1016/17 të datës 09.02.2018, ç' rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës por me qene se sipas akt ekspertimit kemi të bëjmë me lëndime të lehta të përkohshëm pas paragrafit 3 duhet të shtohet lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-ës , ndërsa pjesa tjetër në dispozitiv mbete e pandryshuar.

I akuzuari R. K., në shqyrtimin fillestar të mbajtur thekson e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se këtë veprë e kam kryer në afekt dhe isha në ndikim të alkoolit , kërkojë falje nga e dëmtuara për lëndimin e shkaktuar premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, raportet tona janë të mira dhe nuk kemi me probleme me vete ,andaj i propozojë gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm , faktin se me parë nuk kam qenë i dënuar të me shqiptojë një dënim me të butë.

E dëmtuara E. K., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale me qene se unë edhe në procedurën hetimore kam deklaruar dhe kam paraqitur deklaratë me të cilën kam kërkuar që të njëjti ti ndërprehet masa e paraburgimit gjithashtu shtojë se nuk kërkon kompensim demi me qene se i njëjti është mbajtës i familjes dhe raportet tona janë të mira.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshtëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme nga të cilët formohen të gjitha elemente e veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari R. K. : me dt. 06.07.2017, rreth orës 20:00, në shtëpinë tyre të përbashkët në Gjakovë, rr. ...., i pandehuri, i shkaktonte lëndime trupore të dëmtuarës E. K. në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike ka konsumuar alkool dhe pasi është kthyer në shtëpi nga puna ka filluar ta fyejë të dëmtuarën, të i demolojë dhe ti thyejë gjësendet e shtëpisë, e pasi e dëmtuara i thotë që të ndalet, në shenjë revolte të njëjtën e godet me grushte në pjesë të ndryshme të trupit me ç' rast të dëmtuarës i shkaktonte lëndime të lehta trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se

i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 3 fëmijëve, pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga e dëmtuara për lëndimin që i ka shkaktuar, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, deklarimi i të dëmtuarës se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi meqenëse i njëjti është mbajtës i familjes dhe raportet e tyre janë të mira, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **6 (gjashtë)** muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, ku në rast të revokimit të dënimit me kusht të njëjtit duhet të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 06.07.2018 gjerë me datën 12.07.2018, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari me bindje se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitivin e nenit 41 të KPRK-së, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën pasurore juridike ngase e dëmtuara, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej 110.00 € dhe paushalli gjyqësor në shumë prej 20,00 € është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimin numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.119/18 më datë 16.11.2018**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.